



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:139637

Datë: 28.06.2019

Numri i dokumentit: 00384365

PKR.60/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri dhe anëtarëve të trupit gjykues gjyqtarëve Behar Ymeri dhe Rilind Sermahaj, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të akuzuarve: A. H. me mbrojtësin e tij sipas sipas autorizimit av.Vehbi Ismajli, M. Sh. me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detzreës zyrtare av. Fitim Kosumi dhe V. K., të cilin i mbron sipas autorizimit av.Sevdail Robelli nga Gjilani, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale grabitje nga neni 329 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm : KPRK-s) si dhe i akuzuari A. H. si i vetëm për shkak të veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi , ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo maerieve plasëse, nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I. nr. 16/2018 të datës 01.03. 2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 10 qershor të vitit 2019, edhe atë duke pasur parasysh marrëveshjen për pranimin e fajësisë për dy të akuzuarit e parë, nxjerr dhe në prani të prokurorit të shtetit Mr.sc.Agron Uka, si dhe të të akuzuarëve me mbrojtësit e tyre, kryetari I trupit gjykues në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

AKT GJYKIM

I. Të akuzuarit:

1. A. H. nga babai dhe nëna, e lindur, i lindur më, në Gjilan ku edhe jeton lagja Arbëria , afër shkollës së mesme të Bujqësisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunësuar, me gjendje të varfër ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, nën masën e paraburgimit nga data e gjer më 5 qershor 2018, i tërhiqet vërejtja që gjerë në përfundim të procedurës penale lidhur me këtë

çështje penale, se është i detyruar që ta lajmëroj personalisht apo përmes mbrojtësit të tij në rast se eventualisht e ndërron adresën e tij, nën kërcënim të pasojave ligjore dhe

2.M. Sh., nga babai dhe nëna, e lindur, i lindur më, në Gjilan ku edhe jeton lagja Arbëria, rr.”” nr. 3, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar, me gjendje të varfër ekonomike, i gjykuar për vepër penale lëndim i rëndë trupor dhe se dënimin në kohëzgjatje prej 1 viti e kam mbajtur edhe atë gjatë vitit 2016, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, nën masën e paraburgimit nga data e gjer më 5 qershor 2018, i tërhiqet vërejtja që gjerë në përfundim të procedurës penale lidhur me këtë çështje penale, se është i detyruar që ta lajmëroj personalisht apo përmes mbrojtësit të tij në rast se eventualisht e ndërron adresën e tij, nën kërcënim të pasojave ligjore,

J a n ë f a j t o r ë

a) Sepse më datën 02 janar të vitit 2018, në mes orës 22,00-23,00, në Gjilan, në lagjen “Arbëria” të pandehurit me përgatitje dhe dashje paraprake, në bastoren e të pandehurit, merren vesh – përgatiten - përpilojnë planin për aktivitetin e tyre në bashkëveprim për të kryer veprën penale dhe njëkohësisht në masë të konsiderueshëm dukshëm kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale, ashtu që të njëjtit me qëllim që t’i sjellin vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme duke përvetësuar pasurinë e luajtshme, me anë të përdorimit të forcës dhe armës për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, ashtu që me datë 03.01.2018, rreth orës 01:55 minuta pas mesnatës, në kazonon “Kajot” në rrugën e Ferizajit në Gjilan, në bashkëveprim dhe me dashje kanë përvetësuar pasurinë e luajtshme, duke përdor forcën dhe armën për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, kanë përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme paratë në shumë prej 670 Euro, ashtu që të pandehurit me paramedim dhe me dashje të maskuar kanë kryer grabitje me forcë në kazonon “Kajot” duke hap derën me forcë nën kërcënim të armës dhe thikës, kështu që posa kanë hyrë në kazino kanë bërë shtrinu dhe i pandehuri A. është drejtuar në drejtim të punëtorit të kazinos edhe atë të dëmtuarit I. K. nën kërcënimin e armës ia merr portofolin e punës me para në shumën e lartcekur, kurse i pandehuri M. duke u kërcënuar me thikë nisat në drejtim të pandehurit Veton kinse i njëjti ishte lojtar në kazino dhe nga xhepi i pantollonave ia merr portofolin në të cilin kishte 470 euro dhe pastaj të pandehurit A. dhe M. ikin nga vendi i ngajrjes, ndërsa i pandehuri V. mbetet në kazino dhe në mëngjes i pandehuri A. ia kthen portofolin me 470 euro të pandehurit V., ashtu që pas punës operative të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, të pandehurit kapen dhe arrestohen me datën 11.01.2018.

-ashtu që me këto veprime kriminale të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të **grabitjes nga neni 329 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-s**, ndërsa

b) I akuzuari A. H. si I vetëm me të dhëna personale si më lartë

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse me datën 02.01.2018 rreth orës 22,00 në lagjen “Arbëria” afër shtëpisë së të akuzuarit L. O., pa autorizim ka blerë pistoletën e llojit Zoraki M 906-B me numër serik 000775 me tre fishekë të kalibrit 7,65 mm në shumën prej 300 Euro, i akuzuari me armën lëndore ka kryer veprën penale të grabitjes në kazonon “Kajot” në rrugën e Ferizajit në Gjilan, ashtu që pas punës operative të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, i akuzuari kapet dhe arrestohet më datën 11.01.2018,

-ashtu që me këto veprime kriminale ka kryer veprën penale **importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse** nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK-s.

Gjykata në kuptim të nenit 80 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së të akuzuarit A. H. për veprën penale në pikën a) i cakton dënim kumulativ me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 Euro ndërsa për veprën penale në pikën b) i cakton dënim kumulativ edhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 Euro,

ashtu që në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4,7, 41, 43, 45, 52, 53, 54,73-76 dhe 83 të KPRK-s si dhe neni 365 lidhur me nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s) të akuzuarve në fjalë

I G J Y K O N

Të akuzuarin A. H.:

-me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, të cilin dënim duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe

-me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve dhe në të njëjtën kohë **urdhëron që ky dënim me burgim prej 180 ditëve mos të ekzekutohet,** nëse i akuzuari A. H. nuk kryen vepër tjetër penale gjatë kohës verifikuese prej një (1) viti, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të revokimit të këtij dënimi në kuptim të nenit 53 ose 54 të KPRK-së si dhe

-me dënim unik me gjobë në shumën prej njëmijë (1,000) Euro, të cilën shumë duhet ta paguaj në afat prej pesë muajve në këste të bararta prej nga 200 Euro,

mirëpo, nëse eventualisht ky i akuzuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-ës të njejtit ky dënim

i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëdhjetë(50) ditëve, të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të ftesës për mbajtje ose vazhdim të dënimit lëndor, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm,

ndërsa

Të akuzuarit M. Sh. i caktohet dënim kumulativ edhe atë :

-dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite të cilin dënim duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe

-dënim me gjobë në shumën prej 500 Euro, të cilën shumë duhet ta paguaj në afat prej dy muajve në këste të bararta prej nga 250 Euro,

mirëpo, nëse eventualisht ky i akuzuar dënimin me gjobë nuk mund ta paguaj ose nuk dëshiron ta paguaj në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-ës të njejtit ky dënim

I zëvendësohet me dënim me burgim prej njëzetëpesë (25) ditëve, të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të ftesës për mbajtje ose vazhdim të dënimit lëndor, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Në kuptim të nenit 83 paragrafi 1.të KPRK-s të akuzuarve Adonit Halimi dhe Meriton Shaqiri në dënimet e shqiptuara do të iu llogaritet koha e kaluar në paraburgim duke filluar nga data 11 janar 2018 e deri më datën 05 qershor 2018 për secilin veç e veç.

III. Në bazë të nenit 69 paragrafi 1. të KPRK-ës, të akuzuarve,

I u s h q i p t o h e n

dënimet plotësuese si në vijim: të akuzuarit A. H. **konfiskimi i një shufre metalike** ndërsa të akuzuarit M. Sh. **konfiskimi i një thike me mbetjet e mbathjeve të djegura**, të cilat do të shkatërrohen përmes komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate duke u konstatuar me procesverbal.

IV. Detyrohen të akuzuarit në fjalë që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale edhe atë përkitazi me paushallin gjyqësor në shumat prej nga **njëqind (100) Euro**, **ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumat prej nga pesëdhjetë (50) Euro**, të gjitha në afat prej 30 ditëve, nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

V. Aprovohet pjesërisht kërkesa pasurore juridike e të dëmtuarit I. K. nga Gjilani, ashtu që të akuzuarit A. H. dhe M. Sh. **detyrohen** që të njëjtit t'ia paguajnë shumën prej **gjashtëqindeshtatëdhjetë (670) Euro** edhe atë në mënyrë përpjestimore, të cilën shumë të akuzuarit ia kanë marrë me veprim kriminal për të cilën edhe janë shpallur fajtorë, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Për pjesën tjetër të kërkesës pasurore juridike lidhur me dëmin moral në shumë prej **pesë mijë (5,000) Euro** pala e dëmtuar udhëzohet në **kontest të rregullt civil**.

VI. VEÇOHET procedura penale kundër të akuzuarit V. K. nga Gjilani, duke u urdhëruar fotokopjimi i shkresave të lëndës përkitazi me këtë të akuzuar.

A r s y e t i m

Organi i ndjekjes penale kundër të akuzuarve : A. H., M. Sh. dhe V. K. që të tre nga Gjilani, për shkak të dyshimit të bazuar mirë ka ngritur aktakuzë në drejtim veprës penale në bashkëkryerje nga neni 329 paragrafi 3.lidhur me nenin 31 të KPRK-s ndërsa vetëm për të akuzuarin Adonit edhe veprës penale nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK-s.

Për dy të akuzuarit e parë janë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, të cilat së bashku me aktet tjera shkresore i janë dorëzuar gjykatës, ndërsa i akuzuari i tretë meqë nuk e ka pranuar fajësinë nuk ka paraqitur as parashtrësë për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor i akuzuari I tretë meqë nuk e ka pranuar fajësinë, lënda penale përkitazi me këtë të akuzuar është veçuar, kurse mbrojtësi gjykatës i ka propozuar që t'i ipet afat i mjaftueshëm për negociimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë. Seanca e shqyrtimit gjyqësor është vazhduar përkitazi me dy të akuzuarit tjerë, të cilët I ka shpallur fajtor dhe iu ka shqiptuar dënime meritorë sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Trupi gjykues pas dëgjimit të palëve e në zbatim të nenit 326 paragrafi 1, 4 dhe 6 lidhur me nenin 233 paragrafi 18-22 të KPP-s ka vendosur që t'i aprovoj dënimet e rekomanduara të palëve, të arritura gjatë negociimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, duke i pasur parasysh dispozitat e nenit 75 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 si dhe nenit 73 , 74 dhe 76 të KPRK-s.

Palët kanë mbetur në tërësi pranë marrëveshjeve lëndore.

Njëherit, gjykata është bindur se me dënimet e shqiptuara ndaj dy të akuzuarve në fjalë mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimeve në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, duke i parandaluar të njëjtit por edhe qytetarët potencial që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme.

Gjykata pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët i ka udhëzuar për të drejtën në ankesë, kurse palët shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë andaj edhe në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP më datën **10 qershor 2019** ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm.

Në dënimet e shqiptuara në kuptim të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-s të akuzuarve do të iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.

Në kuptim të nenit 69 të KPRK-s të akuzuarve u janë shqiptuar edhe dënimet plotësues sin ë dispozitiv.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike në shumën prej 670 Euro është vendosur në mënyrë meritore pasi që të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë duke pranuar se të dëmtuarit në fjalë i është grabitur kjo shumë nga të njëjtit. Kurse për pjesën tjetër të kërkesës pasurore juridike përkitazi me kompensimin e demit moral në shumë prej 5,000 Euro pala udhëzohet në contest civil.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP, ndërsa për taksën e kompensimit të viktimave të krimit në kuptim të nenit 39 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr. 05/L-036.

Nga të cekurat e më lartë, në kuptim të nenit 233 dhe 365 të KPP është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr. 60/2019,më dt.10 qershor të vitit 2019**

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të Rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ekzemplarit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

VËREJTJE: Pasi që palët kanë heqë dorë shprehimisht nga e drejta në ankesë në procesverbal, aktgjykimi lëndor bëhet i plotfuqishëm – formës së prerë më datën **10 qershor 2019**.

Numri i lëndës: 2019:139637
Datë: 28.06.2019
Numri i dokumentit: 00384365